

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 495 Data. 30.01.2023
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stok Company



RREGULLORE Për Ndryshimin dhe PLOTËSIM TË RREGULLORES nr.2906 të datës 30.07.2020 Për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të Trepça Sh.A

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2023, miraton këtë:

Mitrovicë, më 26.01.2023



Neni 1 Qëllimi

1.Me këtë rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr.2906 të datës 30.07.2020 për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të Trepça Sh.A

Neni 2 Llojet e masave disiplinore

1.Rregullorja bazike nr.2906 të datës 30.07.2020, Neni 12 i rregullores paragrafit 1 i shtohet edhe një pikë e re nën paragrafi 1.6 si në vijim:

- Dënim me para (në lartësi 5% deri 30% të pagës mujore të punëtorit).

Neni 3 Fusha e zbatimit

1.Rregullorja bazike nr.2906 të datës 30.07.2020, Nenit 12 të rregullores i shtohet edhe teksti si në vijim:

-Masat disiplinore të dënimit me para-gjobë mund tu shqiptohen për çdo shkelje të detyrave të punës të gjithë punëtorëve, në lartësi 5% deri 30% të pagës mujore të punëtorit dhe me kohëzgjatje prej 1 muaj deri në 6 muaj.

-Masën disiplinore nga neni 3 i kësaj Rregullore për plotësim ndryshim të Rregullores për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të Trepça Sh.A, mund të ndërmarre masa Kryeshefi Ekzekutiv me ose pa rekomandimin e udhëheqësit të njësisë biznesore.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për Plotësim Ndryshime të Përgjegjësisë Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në webfaqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A



Dr.Sc. Bahri Hysen

